

Gjimnazi "Loyola" model i edukimit

PRIZREN, 02 SHKURT — Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj, gjatë vizitës në Prizren, lavdëroi gjimnazin klasik gjerman "Loyola", të parin institucion privat të këtij lloji në Kosovë, duke e vlerësuar këtë institucion arsimor si model evropian të edukimit në Kosovë. Ai me këtë rast tha se ministria e Arsimit nuk ka kohë për të humbur, por do të punojë për përmirësimin e kushteve për një arsim sa më cilësor. Ministri Hoxhaj, i shoqëruar edhe nga kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, gjatë vizitës në

Kompleksin e gjimnazit të parë privat "Loyola" në Prizren, mbajti një takim me drejtuesit e kësaj shkolle, me ç'rast nga afër u njoh me mënyrën e organizimit të mësimit në këtë institucion mesimor. "Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit dhe të gjitha institucionet do të

ofrojnë mbështetjen për këtë vatrë diturie, pasi konsiderojmë se ky është një model i edukimit evropian në Kosovë", tha ai. Duke folur rreth reformave të premtuara në arsim, ministri tha se kjo nuk mund të bëhet pa krijimin paraprak të kushteve, përfshirë këtu krijimin hapësirës shkollore që është ndër kushtet e domosdoshme. "Jemi të vendosur që deri më 1 shtator t'i largojmë të gjithë nxënësit nga kontejnerët, ndërsa së shpejti do të ketë një takim edhe me autoritetet prizrenase", tha Hoxhaj.

